



*Republika e Kosovës*



*Komuna Hani i Elezit*

**PLANI  
I  
PUNËS PËR VITIN 2012**

**DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR  
DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

-Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, vitin 2012, do ta vazhdojë me të njëjtin organizim sektorial (urbanizmi, kadastrit, mbrojtja e mjedisit) dhe me të njëjtin numër të zyrtarëve:

- Drejtori i DUKMM
- Tre zyrtar Kadastral,
- Një zyrtar urbanizmi,
- Një inspektor ndërtimi dhe
- Një inspektor mjedisi.

-Buxheti i planifikuar i drejtorisë për vitin 2012 është:

-Paga dhe mëditje .....	34667€
-Mallra dhe shërbime .....	4000€
<u>-Shpenzimet kapitale .....</u>	<u>439024€</u>
-Gjithsej buxheti	477691€

## **SEKTORI I URBANIZMIT**

Objektivat kryesore të këtij sektori për vitin 2012 do të jenë:

1. Realizimin e plotë të projekteve investive të miratuara nga Kuvendi Komunal,
2. Hartimin e Planit Rregullues Urban dhe Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.
3. Përgjigja në të gjitha llojet e kërkesave nga personat fizik dhe juridik,
4. Trajtimin dhe ndalimin e ndërtimeve ilegale,
5. Menaxhimin e pronës shoqërore,
6. Ndihmën e sektorit në menaxhim të shërbimeve publike etj.

### **1.PROJEKTET INVESTIVE**

-Në vitin 2012 prioritet do të jetë në përgatitjen e dokumentacionit për projekte të ndryshme investive duke filluar nga përgatitja e projekteve ideore e gjerë në finalizimin e plotë të projektit (projekti zbatues),paramasave dhe parallogarive si dhe pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave, mbikëqyrjen profesionale të punimeve gjatë realizimit të tyre si dhe pjesëmarrjen në procesin e vlerësimit dhe pranimin të punëve.

-Në këtë drejtim, dinamika e punës së këtij sektori do të ndikohet nga lista e projekteve investive për vitin 2012, të miratuara nga Kuvendi Komunal gjatë vitit të kaluar si dhe hartimi i projekteve të reja të cilat do të gjejnë zbatim në vitin 2012.

**-Më poshtë paraqitet lista e projekteve kapitale investive për vitin 2012, të parapara dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal:**

<b>Nr.</b>	<b>EMRI I PROJEKTIT</b>	<b>REALIZIMI</b>	<b>Vlera e miratuar e projektit €</b>
1	Asfaltimi i rrugës Lagja e re – Pustenik	Mars-Qershor	<b>110.000</b>
2	Rregullimi i Ujësellsëve të fshatrave (Seqishtë ,Laç)	Shtator-Nëntor	<b>2000</b>
3	Pajisje me teknologji informative për sallën e Kuvendit	Shkurt	<b>10.000</b>
4	Shtrimi me kubëza betoni nëpër fshatrat (Krivenik , Seqishtë)	Maj-Gusht	<b>18.000</b>
5	Rregullimi i shtratit të përroit të Dimcës	Mars-Qershor	<b>5.000</b>
6	Softver për kontabilitet	Mars	<b>5.000</b>
7	Asfaltimi i rrugës Dheu i Bardhë – Paldenicë	Korrik-Shtator	<b>40.000</b>
8	Ndërtimi i objektit të Qendrës për punë Sociale,	Shtator-Nëntor	<b>5.000</b>
9	Aneksi i QKMF-së në Han të Elezit,	Shtator-Nëntor	<b>5.000</b>
10	Rregullimi i trotuarit Hani i Elezit –sh.f.”Ilaz Thaçi ( pjesa mbi rrugë)	Korrik-Gusht	<b>10.000</b>
11	Rikonstruimi i rrugës Ura e Fezës-Rrafshe-Meliq,	Mars-Qershor	<b>30.000</b>
12	Furnizimi me transformator të rrymës elektrike në lagjen Kallamoqe	Janar-Shkurt	<b>2.000</b>
13	Rihapja e rrugës Pustenik – Rezhancë – Gorancë	Mars-Prill	<b>2.000</b>
14	Renovimi dhe adaptimi i zyreve në objektin e Komunës(ish salla e mundjes).	Gusht-Tetor	<b>10.000</b>
15	Shtimi rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit	Mars-Nëntor	<b>10.000</b>
16	Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Laç.	Shtator	<b>1.000</b>
17	Fasadimi i objektit të Komunës.	Gusht-Tetor	<b>10.000</b>
18	Shtruarja dhe sanimi i rrugëve.	Shkurt-Dhjetor	<b>10.000</b>
19	Rihapja e rrugës Paldenicë-Neqavc	Mars-Maj	<b>10.000</b>
20	Regullimi i kanalizimit fekal në lagjen Curri	Korrik-Shtator	<b>2.000</b>
21	Fasadimi i objekteve publike.	Qershor-Shtator	<b>10.000</b>
22	Rregullimi i kanalizimit nga rruga e të përndjekurve – Ura e Fezës.	Prill-Qershor	<b>40.000</b>
23	Rregullimi i rrethojës së varrezave të Dëshmorëve.	Maj	<b>30.000</b>
24	Riparimi i rrugës deri te ujësjellësi i Dimcës.	Shtator-Tetor	<b>5.000</b>
25	Paisje me teknologji informative shkollave (llaptop dhe projektor).	Qershor-Shtator	<b>10.000</b>
26	Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqve – sh.f.”Kështjella e diturisë”.	Prill-Maj	<b>10.000</b>
27	Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc.	Shtator-Nentor	<b>5.000</b>
28	Mjetet te lira për bashkë-investime	Mars-Nëntor	<b>20.000</b>

29	Fond për shpronësim	Mars-Qershor	<b>5.000</b>
30	Fond për trajnime	Mars-Nëntor	<b>2.000</b>
31	Rregullimi i infrastruktures shkollore	Qershor-Shtator	<b>4.000</b>
32	Renovimi i Kulmit ndriçues të shkollës së mesme “Dardania”	Qershor-Shtator	<b>10.000</b>
33	Vendosja e kamerave në institucionet publike të Komunës së Hanit të Elezit	Prill-Maj	<b>Donacion 6.000</b>
34	Fond për hartim të projekteve	Janar-Dhjetor	<b>5024</b>
	Gjithsejt		<b>453024</b>

-Po ashtu, gjatë vitit 2012, drejtoria do të jetë e preokupuar me përfundimin e projekteve të pa përfunduara vitin e kaluar siç janë:

1. Përfundimi i asfaltimit të rrugës Hani i Elezit-Gorancë,
2. Përfundimi i ndërtimit të sallës së sporteve pran sh.f. “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit.
3. Instalimi i stacionit për monitorim të përhershëm të ndotjes së ajrit.
4. Shenjëzimi i kufirit Kadastral dhe mbrojtja e pyjeve.

## **2. HARTIMI DHE MIRATIMI I PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS SI DHE HARTIMI I PLANIT RREGULLUES URBAN**

### **▪ Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis**

Në Shtator të vitit 2011 ka filluar hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis i cili po ashtu është një obligim ligjor i Komunës. Hartimi i planit është i paraparë të përfundoj në **Maj** të vitit 2012, kur pritet dhe miratimi i tij nga Kuvendi i Komunës. Ky plan po hartohet nga Komuna me mbështetje të REC-ut dhe financim të SIDA-së Suedeze.

- **Hartimi i Planit Rregullues Urban** .- Në dhjetor të vitit 2011 Kuvendi ka mar vendim për Hartimin e Planit Rregullues Urban i cili do të hartohet gjatë vitit 2012-2013 nga stafi i Komunës me ndihmë të UN-HABITAT –it me financim të SIDA Suedeze. Parashihet që në muajin qershor të mbahet diskutimi publik për profilin.

## **3.PËRGJIGJJA NË TË GJITHA LLOJET E KËRKESAVE NGA PERSONAT FIZIK DHE JURIDIK**

-Në adresë të drejtorisë sonë vazhdimisht vijnë shumë lloje të kërkesave nga ana e qytetarëve dhe personave juridik siç janë: kërkesa për leje ndërtimi,pëlqime, leje të ndryshme shfrytëzimi, etj. Drejtoria jonë është e gatshme që duke respektuar ligjet në fuqi ti përgjigjet në mënyrë efikase këtyre kërkesave dhe gjithmonë në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë tjera si dhe stafin udhëheqës të Komunës.

## **4.TRAJTIMI DHE NDALIMI I NDËRTIMEVE ILEGALE**

-Të gjitha ndërtimet ilegale në Han të Elezit, do të trajtohen duke u bazuar në ligjet të cilat janë në fuqi si:

-Ligji mbi Ndërtimet 2004/15,

-Ligji për Planifikimin Hapësinor 2003/14,

Si dhe akteve të tjera nënligjore si dhe rregullativës Komunale e në radhë të parë Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban. Drejtoria e Urbanizmit është e vendosur në ndalimin e çfarëdo ndërtimi ilegal sidomos kur bëhet fjalë për pronën shoqërore.

### **5.MENAXHIMI I PRONËS SHOQËRORE**

-Pronat shoqërore të cilat tashmë janë në shfrytëzim e sipër do të menaxhohen nga sektori jonë. Banesat në pronësi shoqërore momentalisht janë të menaxhuara nga Agjensioni Kosovar i Pronës (KPA) dhe në rast të ndonjë ndryshimi na do të jemi të gatshëm që me punën tonë të ndihmojmë në zgjedhjen e këtij problemi.

### **6.SEKTORI I KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

-Objektivat kryesorë të këtij sektori për vitin 2012, do të jenë:

- 1) Mirëmbajtja dhe azhurnimi i operatit Kadastral,
- 2) Implementimi i Kadastrit digjital,
- 3) Implementimi i plotë i ligjit mbi themelimin e regjistrit të drejtës së pronës së paluajtshme,
- 4) Rregullimi i çështjeve pronësore juridike sipas dispozitave ligjore në fuqi,
- 5) Trajnime profesionale,
- 6) Mbështetja profesionale Kuvendit Komunal, AKK-së, , FSK ,PK,KFOR-it etj.

-Objektivat e lartpërmendura do të realizohen përmes:

Zbatimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me GTZ-në Gjermane, për mbështetje të Komunës sonë, në ngritjen e kapaciteteve dhe performancës në fushën e kadastrit dhe gjeodezisë për periudhën kohore 2011-2013. Kjo mbështetje ka të bëjë me ndihmën materiale- furnizim të kadastrit me mjete pune dhe vegla të nevojshme kadastrale, si dhe ndihmë profesionale-dy ekspert të GTZ-së do të qëndroj gjatë tërë vitit 2012 në zyrat tona për të mbështetur profesionalisht zyrtarët tonë në ngritjen e performancës së përgjithshme. Qëllimi i këtij projekti është përafrimi i Kadastrit tonë, kushteve dhe standardeve të përcaktuara nga Banka Botrore dhe BE-ja.

Dhe së dyti, Agjensioni Kosovar i Kadastrit, për vitin 2012 ka planifikuar instalimin e programit të ri të RDPP-së dhe Gjeomedisë i cili do të jetë unik për tërë teritorin e Kosovës. Ky program do të mundësoj mirëmbajtje dhe azhurim më të lehtë të operatit Kadastral si dhe ofrim më cilësor të shërbimeve dhe produkteve Kadastrale.

### **7.MBROJTJA E MJEDISIT**

-Sektori i mbrojtjes së mjedisit për vitin 2012 ka planifikuar:

- Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, instalimin e stacionit monitorues të ndotjes së ajrit. Instalimi i stacionit do të mundësoj drejtorisë formimin e qëndrimit adekuat dhe të argumentuar mbi nivelin e ndotjes së ajrit nga industritë ekzistuese e në veçanti nga “Sharr-Cemi

- Implementimin e plotë të ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit,
- Implementimin e plotë të rregullores Komunale mbi mbrojtjen e mjedisit
- Ndërmarrjen e masave parandaluese përmes inspektimeve të rregullta dhe aplikimit të masave ndëshkuese ndaj gjithë atyre që ndotin mjedisin,
- Bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
  - Gjithashtu vëmendje e veçantë do ti përkushtohet edhe organizimit të aksionit për shënimin e ditës ndërkombëtare të Tokës- 22 Prillit.